

VENDIM
Nr. 95/2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 64/2025 “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit,
me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I të vendimit nr. 64/2025 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Deputetja Klodiana Spahiu largohet si anëtare nga Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën.

Deputetja Briseida Çakërri caktohet anëtare në Komisionin për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën.

Deputeti Ilirjan Pendavinji caktohet anëtar në Komisionin për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 6.11.2025.